

V E N D I M
Nr. 90, datë 25.2.1999

**PËR VLERËN E SHITJES SË APARTAMENTEVE TË FINANCUARA, ME FONDE
SHTETËRORE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE**

(Ndryshuar me VKM nr. 429, datë 4.8.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të neneve 7, 16 e 25 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të neneve 1 e 13 të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vlerat e shitjes së apartamenteve të financuara nga Enti Kombëtar i Banesave, përfshirë edhe ato të ndërtuara me fondet e Bankës Botërore, për qytetarët që i përfitojnë ato, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, llogariten në monedhën “lek shqiptar”, bazuar në vlerën e këtij investimi në kohën e kryerjes së tij.

2. Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me kriteret e pikës 1, të kryejë rillogaritjen e detyrimit financiar, për qytetarët që kanë përfutur banesë me fonde shtetërore dhe që kanë shlyer një pjesë të këtij detyrimi.

Në këto raste në çastin e rillogaritjes, nëse qytetari bën pagesë të menjëhershme, i njihet e drejtja e uljes së detyrimit financiar të mbetur, në çdo çast, në masën e përcaktuar në vendimin nr.4, datë 9.1.1995, të Këshillit të Ministrave. Masa përkatëse e uljes së detyrimit financiar të mbetur, përballohet nga buxheti i shtetit.

3. Enti Kombëtar i Banesave, në ato rrethe, ku kostoja e ndërtimit nga ky ent është më e lartë se çmimi mesatar i tregut të lirë të banesave, i cili miratohet çdo vit, me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, lidh kontratën me vlerën e çmimit mesatar të tregut të lirë. Në përputhje me këtë çmim Enti Kombëtar i Banesave të kryejë rillogaritjen e detyrimit financiar për qytetarët që kanë përfutur banesë me fonde shtetërore dhe kanë shlyer një pjesë të detyrimit. Në këto raste, diferenca, ndërmjet kostonë së ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave dhe çmimit mesatar të tregut të lirë të banesave, përballohet nga buxheti i shtetit.

4. Organet e pushtetit vendor dhe Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë të bjënë, përkatësisht, ndarjet e apartamenteve të përfunduara dhe të atyre në proces. Listat përkatëse t’i dërgohen Entit Kombëtar të Banesave, brenda muajit mars 1999.

5. Organet e pushtetit vendor, pas njoftimit nga Enti Kombëtar i Banesave, për apartamentet e ndërtuara nga ky ent, që rezultojnë të pandara nga organet e pushtetit vendor dhe të zëna forcërisht nga qytetarët, të nxjerrin urdhrat administrativë për lirimin e këtyre apartamenteve dhe t’i dërgojnë për ekzekutimin në organet e Ministrisë së Rendit Publik.

6. *Qytetarët e trajtuar me banesë nga organet përgjegjëse, të cilët nuk kanë lidhur ende kontratat e shitblerjes së apartamenteve të financuara nga Enti Kombëtar i Banesave, brenda afatit njëmuor nga dita e lajmërimit prej tij, humbasin të drejtën e përfutimit të pronësisë së apartamentit, të ndërtuar ose blerë me fonde shtetërore dhe këtë të drejtë të përfutimit, Enti Kombëtar i Banesave ia kalon një personi të tretë duke zbatuar radhën në listat e të pastrehëve.*

Qytetarët të cilët janë pajisur me banesë të re nga organet përgjegjëse, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, me kusht dorëzimit të banesës së vjetër, në qoftë se nuk bëjnë dorëzimin e kësaj banese deri në çastin e lidhjes së kontratës së re, humbasin të drejtën e pajisjes me banesën e re dhe Enti Kombëtar i Banesave ia kalon një personi të tretë, duke zbatuar radhën

në listat e të pastrehëve.

7. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.291, datë 21.6.1994, në pikën 1 në paragrafin e parë, fjalët “në dollarë” zëvendësohen me fjalët “lekë shqiptarë”.

Në pikën 2 në paragrafin e parë, fjalët “e konvertuar me vlerën e dollarit në atë moment” zëvendësohen me fjalët “në lekë shqiptarë”.

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.210, datë 1.4.1996, pika 4 shfuqizohet.

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 22.8.1994, në pikën 4 paragrafi i parë, fjalët “në dollarë, sipas kursit zyrtar të këmbimit në momentin e shitjes” zëvendësohen me fjalët “në lekë shqiptarë”.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Ministria e Rendit Publik, Enti Kombëtar i Banesave, prefekturat, orgnet e pushtetit vendor dhe Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko